



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura VI**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Mbledhja nr. 15

Prishtinë, më 6 mars 2018, në orën: 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Valon Ramadani, Fisnik Ismaili, Imet Rrahmani, Xhevahire Izmaku, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Munguan: Jasmina Zhivkoviç dhe Arban Abrashi.

Me ftesë të komisionit, në mbledhje mori pjesë, kryetari i Komunës së Prishtinës, z. Shpend Ahmeti dhe përfaqësuesi i MAPL-së.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit.

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën;**
- 3. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën;**

**Nait Hasani**, duke e njoftuar kryetarin, z. Shpend Ahmeti për vizitat që komisioni parlamentar ka realizuar në Shkup, Tiranë dhe Podgoricë, lidhur me Projektligjin për Prishtinën, ai theksoi

edhe për dallimet dhe analogjitë në mes kryeqyteteve të rajonit me Prishtinën, si dhe dallimet në kompetenca në mes komunave brenda një vendi. Lidhur me këtë, ai pyeti kryetarin e Prishtinës: A ka dallim në kompetenca në mes kryetarit të një komune, me një mijë banorë dhe kryetarit të një komune me njëqind e nëntëdhjetë banorë (Komuna e Parteshit me Komunën e Prishtinës)?

**Shpend Ahmeti**, fillimisht prezantoi qëndrimet e Komunës së Prishtinës për Projektligjin, si ligj të domosdoshëm, me theks të veçantë, si ligj organik në raport me Ligjin për vetëqeverisjen lokale, në kontekstin e kompetencave që komuna do t'i ketë me Ligjin për Prishtinën.

Edhe pse në draftin e ligjit nuk janë përfillur të gjitha kërkesat e Komunës së Prishtinës, si për shembull, çështja e taksës shtesë për kryeqytetin, por kemi zgjedhur një kompromis që të inkorporohen ato që janë më të domosdoshme dhe me prioritet: buxheti, policia komunale, ndërmarrjet publike dhe spitali i qytetit apo shëndetësia sekondare.

Ndërsa, në pyetjen e z. Nait Hasani, ai u përgjigj se ka dallime në kompetenca në mes kryetarëve të komunave të lartcekura, kryetari i Komunës së Parteshit, edhe pse ka një mijë banorë, ka më shumë kompetenca se kryetari i Prishtinës, për arsye se kompetencat e Komunës së Parteshit janë të caktuara si kompetenca të rezervuara.

**Imet Rrahmani**, tha se komisioni duhet të analizojë çështjen e taksës shtesë për Prishtinën, kryeqytetin, ndërsa përkrahu çështjen e formimit të policisë komunale, duke deklaruar se në vendet e rajonit nuk ka interferenca në mes policisë dhe policisë komunale, me kompetenca vetëm për komunën.

Sa i përket çështjes së formimit të spitalit, ai pati dilema. Për arsye të specifikave të sistemit shëndetësor, Prishtina duhet të ketë spitalin e vet, me kompetenca dhe përgjegjësi, në kuadër të QKUK-së, por jo në kuptimin e menaxhmentit dhe licencimit.

**Nait Hasani**, propozoi që në draftin e tekstit të përfshihet edhe çështja për taksën shtesë për kryeqytetin.

**Shqipe Pantina**, përkrahu propozimin për taksën shtesë.

Konstatim: Komisioni kërkoi nga kryetari i Komunës së Prishtinës, që të gjitha propozimet, vërejtjet, lidhur me projektligjin, po që se kanë, t'i sjellin deri në fundjavë, në mënyrë që komisioni pastaj të vazhdojë me hartimin e propozim-amendamenteve për projektligjin.

Mbledhja përfundoi në orën:11:30.

**E përgatiti:**

**Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetari i komisionit,**

-----

Nait Hasani